



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

<i>Data/nr</i>	<b>20/ 05 /2014</b>
<i>Për:</i>	<b>Të gjithë Drejtorët e Drejtorive (Programeve Buxhetore) dhe stafit të përfshirë në procesin buxhetor komunal.</b>
<i>CC:</i>	Znj. Mimoza Kusari – Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës
<i>Nga:</i>	Z. Teki Shala, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, KK Gjakovë
<i>Tema:</i>	Zhvillimi i procesit buxhetor komunal – Përgaditja e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2015-2017, në pajtim me Qarkoren Buxhetore nr.2015/01 për Komuna, të dt.14 Maj 2015.

Të nderuar Drejtorë,

Ministria për Financa në përputhje me Nenin 20 të LMFPF me dt. 14 Maj 2014, ka nxjerrë Qarkoren e parë buxhetore 2015/01 për Komuna për Zhvillimin e procesit buxhetor. Procesi buxhetor kërkon përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), me të cilën sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit komunal , kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestar të financimit të buxhetit të Komunave për vitin 2015-2017.

Me qëllim të përmbushjes së afatit ligjor për përgatitjen e projekt buxhtit në kohën e duhur, është thelbësore që të veprimet në pajtim me kalendarin buxhetor të përcaktuar në LMFPF, dhe Kërkesat e Drejtorive komunale - (Programeve buxhetore), të jenë në përputhje me limitet buxhetore të përcaktuara në këtë Qarkore për Komuna , në kadër të saj edhe për Komunën e Gjakovës.

Komuna gjatë hartimit të të buxhetit për vitin 2015, do të ketë fleksibilitet në planifikimin e të hyrave vetanake nëpër kategoritë ekonomike ( duke përfshirë kategorinë ekonomike Paga & Meditje dhe kapitalet).

Ndërsa, sa i përket planifikimit dhe shpenzimit të të hyrave vetanake në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë , i referoheni dispozitave ligjor të përcaktuar në LMFPF, LFPL dhe ligjin vjetor të buxhetit.

Numri i të punësuarve mbetet në nivel të vitit paraprak, ndërsa masa monetare për paga dhe meditje do të përfshijë rritjen e pagave prej 25% sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 01/176 datë.10

Mars 2014, si dhe në rast kur për këtë ekziston Vendimi paraprak nga Kuvendi apo Qeveria e Republikës së Kosovës.

Pra, duke u nisur nga dispozitat e lartëshenuara ligjor dhe Udhezimeve të përshkruara ne Qarkoren buxhetore nr, 2015/01 për Komuna **Kërkojm nga ana e Juaj** që të filloni me përgaditjen e Kërkesave të para buxhetore të Drejtorive (Programeve buxhetore) që ju udhëhiqni, për periudhën 2015-2017.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëveprim me Kryetaren e Komunës do të organizon punëtori me gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore dhe stafin e përfshirë në procesin e hartimit të buxhetit komunal për vitin 2015.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Udhëheqësin e Sektorit për Buxhet – z. Xhavit Uka, në zyrën nr. 58.

**Vëmendje:**

Qarkoren buxhetore nr. 2015/01 për Komuna të lëshuar nga Ministria e Financave ju kemi dërguar me e-mail zyrtar.

---

Me respekt,  
Teki Shala, PhD